# AKTI THEMELUES

## I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## "SH.P.K. ELTON"

Neni 1

Ne baze te ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" une i quajturi Flamur Kollozi i biri i Mustafait dhe i Bukuries i dt. 1959, lindur e banues ne Fier, me zotesi te plote juridike per te vepruar shpall formimin e shoqerise private tregetare me pergjegjesi te kufizuar SH.P.K te quajtur "ELTON"

Neni 2

Shoqeria si person juridik zhvillon veprimterine e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se shqiperise, neperputhje me legjislacionin ne fuqi, statutin dhe kete akt themelimi.

## O B J E K T I I   S H O Q E R I S E

Neni 3

Objekti i shoqerise eshte:

- Tregetim , import eksport i mallrave te ndryshme ushqimore, industriale lende djegese, karburante, materiale ndertimi, hidrosanitare, elektroshtepiake, elektroteknike, pjese kembimi per automjete, me shumice dhe pakice brenda dhe jashte Shqiperise.

## KAPITALI I SHOQERISE

Neni 4

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 lek me para dhe i depozituar ne Banken e Shtetit Shqiptar.

Ky kapital eshte vene vetem nga ortaku i vetem themelues Flamur Kollozi.

## SELIA E SHOQERISE

Neni 5

Selia e shoqerise eshte ne kete adrese:

Flamur Kollozi, lagje "Apollonia" Bashkia Fier.

Shoqeria mund te hap edhe vendqendrime te tjera, operative dhe filiale ne teritorin e Republikes se Shqiperise,

NOTER FIER

## AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 6

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saje tregetare mbi dhjete vjete te njepasnjeshem e larte.

Aktiviteti i saj mund te zgjat me shume se dhjete vjete, por edhe mund te nderpritet ne cdo kohe me vendim te ortakut themelues, sipas rasteve te parashikuara ne statut.

Neni 7

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet fiskale dhe sigurimet shoqerore.

Neni 8

Fitimi i realizuar nga shoqeria eshte kopetence eskluzive e ortakut te vetem i cili vendos per perdorimin e tij dhe per krijimin e fondit rezervo.

Neni 9

Shoqeria fillon (fiton zotesin per te vepruar me regjistrimin e saj regjistrin Tregetar ne Gjykaten e Rrethit Tirane.

Neni 10

Shoqeria fillon aktivitetin e saj tregetar, momentin e regjistrimit ne organin kopetent shtetror per marjen e licenses (Dega e tatimeve Fie:

## D R E J T I M I  D H E  ADMINISTRIMI ISHOQERISE

Neni 11

Menyra dhe drejtimi i shoqerise jane te percaktuara ne statutin e shoqerise.

Administratori i shoqerise caktohet Z.Flamur Kollozi (Ortaku ivetem).

Neni 12

Mardheniet e punes ne shoqeri rregullohen me baze te legjislacionit te punes, me kontrata individuale dhe kolektive, midis shoqerise dhe punemaresve.

Neni 13

Shoqeria ka vulen e saj ne te cilen shkruhet:

"SH.P.K ELTON" Fier.

VIJESHMERIA E AKTIT THEMELUES

Neni 14

Ky akt themelues eshte lidhur per nje periudhe jo me pak se dhjete vjete, por ky afat mund te ndryshoje sipas vendimit qe do te marre ortaku i vetem i shoqerise.

ZGJIDHJA E MOSMARVESHJEVE

Neni 15

Te gjitha mosmarveshjet qe mund te lindin ne veprimtarine e shoqerise do te zgjidhen nga gjykata, ne rast se nuk do te zgjidhen me mirkuptim dhe konsensus.

Neni 16

Ceshtjet qe nuk jane rregulluar ne kete akt themelimi rregullohen ne statutin e shoqerise qe i bashkengjitet si pjese perberese e saj.

Neni 17

Ne qofte se shoqeria do te pushoje veprimtarine e saj, atehere do te caktohet nje komisjon likujdimi i cili do te paraqes bilancin e shoqerise per likujdimin e saj.

Neni 18

Ky akt themelimi hyn ne fuqi daten e nxjerjes dhe te nenshkrimit nga ortaku i vetem themelues.

ORTAKU I VETEM THEMELUES
(Flamur Kollozi)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA FIER
Nr. 934 Rregj. 934

Fier, me 3.03.1998

VERTETIM

Vertetohet se sot me dt. 3.0.3.1998, para meje Noterit Minella Milo u paraqit Z, Flamur Kollozi i biri i Mustafait dhe i Bukuries i dt. 1959 banues ne Fier, me zotesi te plote juridike per te vepruar i identifikuar sipas ligjit dhe nenshkroi aktin e themelimit te mesiperm ne prezencen time.

NOTERI
(Minella Milo)

# S T A T U T

## I SHOQERISE PRIVATE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## " SH. P. K. ELTON"

Ne mbeshtetje te ligjit 7638 dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" une i quajturi Flamur Kollozi i biri i Mustafait dhe iBukuries i dt. 1959 lindur dhe banues ne Fier ne lagjen "Apollonia", me zotesi te plote juridike per te vepruar, shpall formimin e shoqerise private tregetare me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K.) te quajtur"ELTON" me statutin si me poshte:

### FORMIMI I SHOQERISE TREGETARE "ELTON"

Neni 1

Formohet shoqeria private tregetare e quajtur ELTON", shoqeri me pergjegjesi te kufizuar SH.P.K nga Z. Flamur Kollozi (Ortaku i vetem), qe perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 2

Objekti i shoqerise eshte:

- Tregetim, import eksport i mallrave te ndryshme ushqimore, industriale lende djegese, karburante, materiale ndertimi, hidrosanitare, elektroshtepiake, elektroteknike, pjese kembimi per automjete, me shumice dhe pakice brenda dhe jashte shqiperise.

### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj mbi dhjete vjete te njepasnjeshme e larte.

Neni 4

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin e saj, selin dhe objektin e saj me vendimin qe do te marre ortaku i vetem i shoqerise.

### SELIA E SHOQERISE

Neni 5

Selia e shoqerise eshte ne kete adrese:

Flamur Kollozi lagje "Apollonia " te Bashkise Fier

Shoqeria mund te hap edhe vendqendrime te tjera operative dhe filiale ne teritorin e Republikes se Shqiperise.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 lek.

Ky kapital eshte vene nga Ortaku i vetem i shoqerise Flamur Kollozi.

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose paksohet me te gjitha menyrat e lejuara nga ligji, ne baze te vendimit qe do te marre ortaku i vetem i shoqerise.

Neni7

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirishte te transferueshme ndermjet ortakeve, gjithashtu pjeset e kapitalit themeltar mund te trasferohen edhe tek te tretet, persona fizik ose juridik me pëlqimin e ortakev

Gjithashtu ato jane te transferushme ne raste ndarje pasurore mes bashkeshorteve si dhe ne rruge trashegimie.

Trasferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te behet me akt noterial.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 8

Shoqeria drejtohet dhe administrohet nga nje ose me shume drejtues (Administrator), perona fizik, pjesmares ose jo ne shoqeri, me ose pa kufizim mandati te tyre te zgjedhur nga ortaku themelues.

Neni 9

Ortaku i vetem dhe administratori i kesaj shoqerie eshte Flamur Kolloz:

Ai sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise se shoqerise emron administrator, keshillin drejtues dhe puneson specialist dhe punonjes te aktiviteteve te ndryshem.

Neni 10

Ortaku i vetem percakton drejtimet kryesore te veprimtarise se shoqerise si dhe drejton, organizon dhe kontrollon kete veprimtari.

Miraton planin ekonomiko financiar, bilancet, deklaratat e ndryshme si dhe merre masa per plotesimin e kerkesave te parashikuara ne dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 11

Ortaku i vetem miraton rregulloren e brendeshme te aktivitetit te shoqerise, strukturen organizative, lidh kontrata me te tretet dhe vendos per zgjidhjen e tyre neperputhje me legjislacionin ne fuqi.

NOTER
FIER



Neni 12

Ortaku i vetem vendos per marrjen e kredivedhe perdorimin e tyre.

Neni 13

Ortaku i vetem lidh kontrata individuale dhe kolektive sipas rastit per realizimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin e punes dhe statutin te cilat jane te detyrushem per tu zbatuar.

Neni 14

Perfaqesimi i shoqerise i perkete ortakut te vetem si dhe administratoreve ne rastet e autorizuara.

Ata kane te drejte te perfaqesojne shoqerine ne organet gjyqesore dhe ne organet e ndryshme shtetrore, vete ose nepermjet avokateve te caktuar prej tyre.

Neni 15

Mosmarveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te punesuarve do te zgjidhen nga gjykata ne rast se ato nuk do te zgjidhen me mirkuptim dhe konsensus.

Neni 16

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakoneshme ne te cilen shkruhet ; "SH.P.K.ELTON" Fier.

Neni 17

Emertimi i shoqerise, kapitali themeltar dhe emrat e ortakeve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat e nxjera nga kjo shoqeri qe ju drejtohet te treteve.

Neni 18

SEKRETI I PUNES

Konsiderohen si sekrete te punes te kesaj shoqerie te gjitha aktet dhe dokumentat qe jane vendosur nga ortaku i vetem i shoqerise.

KONTROLLI I BRENDSHEM

Neni 19

Shoqeria organizon kontroll te brendshem me ekspert kontabel te autorizuar ose te emruar me afat te caktuar ose te pacaktuar ne baze te kerkesave ligjore.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 20

Shoqeria nderton veprimtarine ekonomiko financiare mbi bazen e le·

vendise ne kushtet e konomise se tregut te lire mbeshtetur ne kapitalin e saj, ne fondin themeltar e mjetet e xhiros, mundesit e kreditimit dhe te huazimit nga shteti apo persona te tjere fizik e juridik, brenda e jashte vendit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, me mundesin e investimeve.

Veprimtaria ekonomike kryhet ne vazhdimesi dhe gjen pasqyrimin e saj ne bilancin periodik.

Neni 21

Shoqeria ka llogarine rrjedhese te saj ne Banken e Shtetit Shqiptar dhe mund te hap edhe ne vende te tjera nepermjet te cilave kryen veprime e saj bankare.

Neni 22

Ne bilancin periodik pasurit e saj jane te shprehura ne monedhen shqiptare dhe sipas rastit edhe ne monedha te huaja ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Ne baze te legjislacionit shoqeria percakton edhe formen e bilanceve e te llogarive per dokumentimin e veprimtarise ekonomiko-financiare.

Neni 23

Bilanci mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti.

Llogaria vjetore, inventari, raporti mbi operacionet e vitit financia dhe raportet e hartuara nga ekspertet kontabel, miratohen ne mbledhjen e asamblese brenda nje afati kater muajsh nga data e mbylljes se vitit fin ciar.

Neni 24

Shoqeria kur e shikon te perligjur mund te investoje ne ndermarj x shoqeri e persona te tjere fizik e juridik, vendas e te huaj kapitalet e saj.

Neni 25

Ne shoqeri munde te aderojne edhe persona te tjere ne kushtet e ca ktuara nga ortaku themelues i shoqerise,

Neni 26

Personat aderues kane po ato te drejta dhe detyrime si ortaku themelues. me perjashtim te atyre kufizimeve qe jane vendosur me rastin e ade rimit te tyre ne shoqeri.

Neni 27

Me rastin e largimit te personave aderues, ata mbartin me vehte pjesen e fitimit qe u takon deri ne momentin e largimit te tyre, si dhe cd

detyrim qe ka shoqeria per kete periudhe.

Neni 28

Perdorimi i fitimit te shoqerise eshte kopetence eskluzive e ortakut te vetem te shoqerise, i cili vendos per perdorimin e tij dhe per krijimin e fondit rezerve.

Neni 29

Shoqeria deklarohet e krijuar daten e regjistrimit ne Regjistrin Tregetar ne Gjykaten e Rrethit Tirane.

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ekonomike me rregjistrimin si subjekt privat ne organin tatimor perkates ne Rrethit Fier.

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 30

Shoqerda pushon veprimtarine e saj ne keto raste:

- Ne rastet e parashikuara ne ligj.
- Ne raste ndarje, bashkimi me persona te tjere fizik e juridik.
- Ne raste pamundesie per te vazhduar veprimtarine per te cilen eshte krijuar.
- Me urdher te organit kopetent shtetror si rrjedhoje e shkeljes se ligji
- Kur perfundon qellimin per te cilin eshte krijuar.

Ne keto raste shoqeria krijon komisjonin e likujdimit i cili paraqet bilancin e likujdimit ne mbledhjen e asamblese.

Mbas mbylljes se shoqerise, ajo kryen te gjitha veprimet dokumentare te nevojeshme per cregjistrimin nga regjistri tregetar.

Neni 31

Ky statut hyne ne fuqi diten e nenshkrimit nga ortaku i vetem themelues i shoqerise.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
SH.P.K. ELTON
(Flamur Kollozi)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA FIER
Nr. 933 Rregj.

PULLE TAKSE 50 LEKE

Fier, me 3/03/ 1998

V E R T E T I M

Vertetohet se sot me dt. 3/03/ 1998, para meje Noterit Minella Milo u paraqit Z. Flamur Kollozi, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar i identifikuar sipas ligjit dhe nenshkroi statutin e mesiperm ne prezencen time.

N O T E R I
(Minella Milo)